

KAPITULLI I

1.PROJEKT PËRMIRËSIMI

Emri i objektit: Kodra e kishës

Njësia e Vetqeverisjes Vendore:Fajza

Fshati: Tregtan

Ekonomia Pyjore:Tregtan

Ngasta, n/ngastra:73

Sipërfaqia totale:sip 12.79 ha.

Sipërfaqia që do përmisohet 4.3 ha

Sipërfaqia që do përshkohet me punime: 4.3 ha

Lloji i ndërhyrjes: Rrallime .

Përmirësim pyjesh (Rrallime) të llojit Cungishte

KAPITULLI II

2.QËLLIMI I PËRMIRËSIMIT DHE KARAKTERISTIKAT STACIONALE

2.1.Qëllimi i përmirësimit:

Krijimi i kushteve optimale të hapsirës, ushqimit dhe dritës, për rritjen e prodhimtarisë së grumbullit pyjor, pastrimin e sipërfaqes nga mbeturinat, prerjen e cungjeve, për mbrojtjen e grumbullit pyjor nga zjarret.

2.2.Pozicioni i objektit:

Në Veri – Perendim të fshatit Tregtan , largësinë nga qendra e Njesisë Administrative Fajza 8 km dhe 15 km nga qendra e Bashkisë, rrjetin rrugor.

2.3. Vendosja Gjeografike dhe administrative.

Objekti ndodhet në Njesin Administrative Fajza ,shtrirja është Veri – Perendim.

2.4.Përdorimi deritanishëm:

Është trajtuar si grumbull pyjor prodhues. Para viteve 1990 është shfrytëzuar nga ndermarrja e shfrytëzimit për prodhim dru zjarri, pas 1990 është shfrytëzuar nga fshatarësia për ngrohje .

2.5.Klima.

Mesdhetare kontinentale, karakterizohet nga: dimer të ftohtë, e me reshje shiu e dëbore, si dhe verë të nxehtë e të thatë.

2.6. Toka:

E hinjte kafe, thellësinë:11- 25 cm, trashësinë e shtresës së humusit:3-5 cm, formacionin amnor: Ultrabazikë ,hidrografia : përrua, sezonal.

2.7. Orografia:

Forma e terrenit shpat.

2.8.Kundrejtimi:

Ngasta nr :73 kundrejtimi Veri- Peredim.

2.9.Pjerrësia:

Pjerrësia në grade Ngasta Nr: 73 është 15.3 .

2.10. Lartësia mbi det:

Lartësia mesatare për Ngasta Nr: 73 është 688 Mbi nivelin e detit

2.11. Veshja bimore:

Pyje të dominuara nga *Quercus pubescens* L. Funkcionin : prodhues, forma e qeverisjes Cungishte, llojet drunor që ndodhen në objekt: BN, BUN.

Nënpylli: gram, të jera ,trandafil i egër .

Bimesia barishtore: është e rrallë, kryesisht graminace, leguminose, etj me gradë veshje 30-35%.

2.12. Rezultatet e pritshme (Konkluzione):

Ndërhyrja me punime silvikulturale të tipit rrallim në këto objekt ndikon pozitivisht në përmirësimin e strukturës së grumbullit pyjor, cilësinë e lëndës drusore që do të rezultojë në moshën e shfrytëzimit. Gjithashtu një impakt pozitiv realizimi i këtij investimi do ketë në zbutjen e varfërisë të banorëve të zonës, uljen e nivelit të papunësisë si dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për mbrojtjen e fondit pyjor.

KAPITULLI I III

3. TË DHENAT SPECIFIKE PËR PARCELAT.

2.1. Prshkrimi i grumbullit pyjor

Të përshkruhen në mënyrë të detajuar të dhenat e secilës parcele sipas planit të mbarshtrimit si dhe shprehen masat e propozuara për secilën parcelë.

Nr.Parc	Sip.(ha.)	LlojetPërbërëse	Mosha(vjet)	Lartësia(m.)	Diametri(cm.)	Kurordendësia	Volumi(m ³ /ha)	Nr.Drurve/ha	Sip.Bazimetrike m ² /ha.	Gjëndjasanitarevegjetative	Masat e propozuar	vitiunderhyrjes
73	4.3 ha	Dushk	0-10	3.65	2.81	E lartë	2.14	5600	3.37	E mire	Rrallim	2024

2.2. Përshkrimi i grumbullit pyjor pas ndërhyrjes

Të përshkruhen në mënyrë të detajuar të dhenat e secilës parcele pas ndërhyrjeve me përmirësime.

Nr. Par c	Sip. (ha.)	Ll.Përbërëse	Mosh a (vjet)	Lartësi a (m.)	Diamet ri (cm.)	Kuror dendësi a	Volu mi (m ³ /ha)	Nr. Drurv e/ha	Sip. Bazime trike m ² /ha.	Gjëndja sanitare vegjetati ve
73	4.3	Dushk	0-10	3.65	2.81	E lartë	1.6	4200	2.52	E mire

2.3. Volumi i materialit drusor që do hiqet si rjedhojë e ndërhyrjeve.

Të përshkruhen në mënyrë të detajuar volumi për secilën parcelë dhe i detajuar sipas asortimenteve që do të prodhohen nga ndërhyrjet.

Nr. Parc	Sip. (ha.)	Llojet Përbërëse	Lartësia (m.)	Diametri (cm.)	Nr.Dru/ha do hiqen	Volumi (m ³ /dru)	Volumi (m ³ /ha)	Volumi ngas(m ³)	Asortimenti
----------	------------	------------------	---------------	----------------	--------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------	-------------

73	4.3	Dushk	3.65	2.81	1400	0.004	5.6	24.08	Dru zjarri
----	-----	-------	------	------	------	-------	-----	-------	------------

3.4. ZBATIMI I PUNIMEVE

3.4.1. Historiku i punimeve të kryera:

Eshtë shfrytëzuar nëpërmjet ricungimit nga ndërmarrja e shfrytëzimit pyjor para vitit 1990. Nuk janë kryer punime të tjera silvikulturore në këtë objekt.

3.4.2. Mënyra e përmirësimit:

Pastrim pyjesh te llojit Dushk, duke hequr 25 % të drureve si dhe duke krasitur 3–4 vertiçilet e poshtëme të të gjithë drurëve. Prerja e cungjeve të thata si dhe lenja e degve dhe e drurve të pa vlerësueshëm, të shpërndarë në parcelë pasi pas dekompozimit e pasurojnë token me humus. Materiali i vlerësueshëm të hiqet nga parcela dhe të përdoret për plotësimin e nevojave të komunitetit me dru zjarri për ngrohje, hunje domatesh ose për gardhime të ndryshme, duke minimizuar mundësinë e përhapjes së zjarrit

3.4.3. Intensiteti:

Përshkruaj intensitetin në 25 % të ndërhyrjes.

3.4.4. Periodiciteti i prerjeve:

Periodiciteti 8-10 vite.

3.4.5. Teknika e zbatimit të punimeve:

Gjatë procesit të punës të hiqen 25 % e numrit të drurëve. duke hequr drurët e nënshtruar, të bigëzuar, me maja të thara, duke ju dhënë përparësi drurëve të llojit dushk dhe llojeve të tjera industriale pjesëmarrës në grumbull si frashër, panjë, vadhviçe, dëllinjë, me zhvillim më të mirë si dhe të krasiten 3–4 vertiçilet e poshtëme të drurëve, duke u prerë rrafsh me Trungun. Të priten të gjithë cungjet e thara nga dukurit natyrore dhe prerjet abuzive. Cungjet të priten rrafsh me sipërfaqen e tokës. Mbeturinat e pa vlerësueshme të shpërndahen në parcelë, pasi pas dekompozimit shërbejnë për pasurimin e tokës me humus.

Veglat e punës që përdoren për kryerjen e punimeve të jenë të mprefta mirë, në mënyrë që gjatë procesit të krasitjes së degëzave të kurorës, të mos shkaktohen plagë në trungun e drurit

3.4.6. Sasia e materialit drusor që prodhohet;

Ngastra nr:73 material i vlersuar 24.08 m³ Dru zjarri.

3.4.7. Destinacioni i materialit të prodhuar:

Drutë e zjarrit që rezultojnë gjatë procesit të pastrimit, do të shërbejnë për plotësimin e nevojave të fshatarësisë për ngrohje kundrejt likujdimit të detyrimeve financiare që do përcaktojnë bashkia .

3.4.8. Masat mbrojtëse:

Objekti nuk është i ekspozuar ndaj kullotjes, megjithatë pas kryerjes së punimeve duhet të mbrohet nga kullotja.

3.4.9. Rreziqet:

Zjarret janë rreziku kryesor i pyjeve të zonës, prandaj stafi i menaxhimit të fondit pyjor publik të bashkisë, duhet të tregojë kujdesin e mjaftueshëm për sensibilizimin e komunitetit dhe mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.

KAPITULLI I IV

4.KRYERJA E PUNIMEVE

4.1.Grafiku i punimeve:

Aktiviteti	Muaji							Grupi i implementimit
	(kutintë e selektuara tregojnë aktivitetet e planifikuara, nga muaji i parë i zbatimit të projektit)							
	1	2	3	4	5	6		
A1.Sigurimi i fuqise punetore te nevojeshme per realizimin e punimeve								Subjekti Fitues
A2.Trajnimi i punëtorëve që do merren me realizimin e punimeve.								Stafi drejtues i Subjektit dhe drejtuesi teknik i punimeve.
A3. Pastrim pyjesh te llojit Dushk, duke hequr 15-25 % të drureve si dhe duke krasitur 3–4 vertiçilet e poshtëme të të gjithë drurëve								Stafi drejtues i Subjektit, drejtuesi teknik i punimeve, punëtorët e trajnuar.
A4. . Prerja e cungjeve të thata si dhe lenja e degve dhe e drurve të pa vlerësueshëm, të shpërndarë në parcelë pasi pas dekompozimit e pasurojnë token me humus								Stafi drejtues i Subjektit, drejtuesi teknik i punimeve, punëtorësia.
A5, Kontrolli i punimeve dhe hartimi i dokumentacionit përkatës								Grupi i monitorimit (Ministria e Mjedisit , AKP , drejtuesi teknik, DSHP Bashkia Has.

- **Grafiku i punimeve:**

- a. Rrallimet dhe krasitja e 3-4 vertiçileve të poshtëme të drurëve që do ngelen, do të përfundojë brenda 6 mujajve nga fillimi i punimeve (Lidhja e kontratës).
- b. Prodhimi dhe sistemimi i lëndës drusore (dru zjarri) në anë të rrugës 2 muaj pas përfundimit të punimeve të rrallimit e krasitjes.
- c. Pastrimi i ngastrës dhe grumbullimi i mbeturinave 15 ditë pas sistemimit të lëndës drusore. Punimet do të përfundojnë 6 muaj nga data e fillimit të punimeve (Lidhja e kontratës).
- d. Punimet mund të kryhen gjatë gjithë periudhës së vitit.

4.2.Shpenzimet për realizimin e projektit:

Për realizimin e punimeve të planifikuara në kete projekt, bazuar në manualin e Normave e punes me krah dhe me kafshë për punimet bujqësore dhe Pyjore, Përmirësime Pyjesh ,5.b) Duke hequr 25 % të numrit të drurëve: Në dushqe : Njesia matëse m² 350 dhe çmimeve për njësi është 1840 duke ju referuar VENDIMIT Nr:113 datë:01.03.2023 PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI, janë hartuar preventivat perkates të cilët kanë vlerë totale **298742.4** lekë.

Të dhënat sipas modelit teknik të punimeve janë:

Impakt pozitiv realizimi i këtijë investimi do kete në zbutjen e varfërisë të banorëve të zonës, uljen e nivelit të papunësisë si dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për mbrojtjen e fondit pyjor.

Sensibilizimin e komunitetit për mbrojtjen e objektit.

4.4.Kuotimi për bazën materiale:

Baza materjale që do të shërbej për kryrjen e punimeve , përlllogaritet që ti ketë subjekti fitues.

4.5.Analiza e riskut:

- (Realizimi i këtijë investimi nuk është i ekspozuar ndaj faktorëve të rriskut, pasi paraprakisht është marrë mendimi i komunitetit, gjithashtu egziston dhe mundësia e sigurimit të fuqisë punëtore të kualifikuar për kryerjen e punimeve të parashikuaranë fshatrat në afërsi të objektit.

I vetmi faktor që mund të ndikojë në zgjatjen e afateve të kryerjes së punimeve mund të jetë trashësia e dëborës gjatë periudhës së dimrit.

KAPITULLI V

ANEKSE

5.1.Foto dixhitale të vendit ku do të realizohen punimet:

5.2.Planimetria e objektit:



5.3.Harta e ngastres e gjeoreferuar

HARTA E GJEOREFERUAR
EKONOMIA PYJORE "TREGTAN" Ngastra Nr.73
 Sip qe do kryhen punime 4.3 ha
 SH 1:10.000

